



REPUBLIKA E SERBISË
MBROJTËSI I QYTETARËVE



Mbrojtësi i qytetarëve

21-6/12
Beograd

nr.ref. 1920 data 26. 1. 2012.

QEVERIA E REPUBLIKËS SERBE
-dr Mirko Cvetković, Kryetar i Qeverisë -

BEOGRAD
Rr. Nemanjina 11

Të nderuar,

Duke vlerësuar, në bazë të procedurave të kryera sipas ankesave të qytetarëve, adresimin e shoqatës së qytetarëve "Praxis" dhe "Qendrës për Avancimin e Studimeve Ligjore", njohuritë e fituara në bashkëpunim me Komisaratin e Lartë të OKB-së për Refugjatë, që ekziston nevoja për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, rregullores dhe akteve nënligjore lidhur me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, në pajtim me nenin 18 paragrafin 2 të Ligjit për Mbrojtësin e qytetarëve ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 79/2005 dhe 54/2007), paraqes

INICIATIVËN

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PROCEDURËN
JASHTËKONTESTIMORE**

Është i nevojshëm të ndryshohet Ligji mbi procedurën jashtëkontestimore në mënyrë që qytetarëve të cilët, për arsye objektive, nuk mund t'i plotësojnë kushtet për regjistrim në librin amë sipas dispozitave Ligjore për librat amë, (mungesa apo pamundësia për të provuar të dhënat personale para organit administrativ), t'iu mundësohet që me procedurë jashtëkontestimore ta dëshmojnë statusin e tyre para gjykatës, dhe që gjykata të mund të përcaktojë faktet e nevojshme për regjistrim në librat amë. Kjo për arsyet vijuese:

Në Republikën e Serbisë, jeton një numër i caktuar i personave të cilët asnjëherë nuk janë regjistruar në librin amë të lindjeve, ose librat në të cilën ata ishin të regjistruar janë shkatërruar apo humbur, dhe ata nuk kanë dokumente ose prova të tjera në bazë të të cilëve do të mund të zgjidhej statusi i tyre. Këta persona për sistemin ligjor janë të "padukshëm" dhe për këtë arsye nuk ushtrojnë të drejtat e tyre civile dhe të tjera. Më së shpeshti, bëhet fjalë për persona me origjinë romë. Sipas raportit të Komisarimit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, i cili u botua nën titullin "Personat në rrezik nga pashtetësia në Serbi" në qershor 2011, 1.5% e pjesëtarëve të përkatësisë romë, ashkali dhe egjiptian, nuk janë të regjistruar në librin amë të lindjeve. Duke marrë parasysh vlerësimin që e ka deklaruar Qeveria Serbe në Pyetësorin e Komisionit Evropian, sipas të cilit në Serbi jetojnë rreth 450,000 romë, rezultatet e anketës tregojnë se ka rreth 6,750 persona "juridikisht të padukshëm" në Serbi.

Për regjistrim në librin amë të lindjes, sipas dispozitave Ligjore për librat amë dhe akteve tjera nënligjore, është e nevojshme që parashtruesi i kërkesës për regjistrim të sigurojë dëshmi që vërteton fakte të caktuara në lidhje me lindjen dhe identitetin e tij, siç janë: vendi, dita, muaji dhe viti lindjes, informacion në lidhje me prindërit etj., çka personat "ligjërisht të padukshëm" të nacionalitetit rom shpesh nuk mund t'i sigurojnë. Regjistrimi i të dhënave për prindërit është i domosdoshëm, dhe bëhet në bazë të dokumenteve përkatëse (certifikata e lindjes, certifikata e shtetësisë, letërnjoftimi) dhe me pjesëmarrje të detyrueshme të të dy prindërve, ose të paktën të nënës, në procedurë. Megjithatë, në realitet, në mes të personave të përkatësisë rome, ka një numër i madh i familjeve, anëtarët e të cilëve me gjenerata nuk i posedojnë dokumentet, dhe të cilët për shkak të jetës së diferencuar në shoqëri dhe të gjendjes të përjashtuar sociale, nuk kanë as të dhënat themelore të nevojshme për regjistrim në librin amë.

Duke qenë se me rregullore nuk është e rregulluar mënyra efikase për regjistrim në librin amë të lindjeve për të rriturit të cilët nuk kanë dokumentet e nevojshme, të dhënat e nevojshme, prindërit e të cilëve janë të panjohur ose nuk janë në dispozicion, ata janë të detyruar që me vite të zhvillojnë procedura të ndryshme pa një vendim të qartë. Kërkesat e tyre për regjistrimin e mëvonshëm shpesh janë refuzuar, ose procedurat janë ndërprerë, ndërsa parashtruesit e kërkesave udhëzohen në iniciimin e procedurës jashtëkontestimore për vërtetimin e atësisë dhe amësisë. Gjatë procedurës për rastet jashtëkontestimore, këta persona përsëri ballafaqohen me pengesa të shumta - gjykatat kërkojnë që palët të paraqesin provat në bazë të të cilëve mund të konstatohet emri dhe identiteti i tyre, çka në këto raste palët nuk mund t'i ofrojnë; shpallen si jo kompetent, ndërsa në situatat kur veprojnë sipas kërkesës së palëve shpesh kërkojnë paraqitjen e provave përmes analizave të ADN-së çka për këta persona në aspektin e kostos paraqet kërkesë të pakapërcyeshme. Shpjegimet e vendimeve të marra tregojnë se qëndrimi i gjykatës për këtë çështje është plotësisht jo unik, ndërsa zhvillimi i këtyre procedurave nuk është zgjidhje dhe vetëm që paraqet përpjekje të padobishme për të kompensuar mangësitë e legjislacionit aktual për regjistrim të mëvonshëm në librin amë të lindjes.

Personat ligjërisht të padukshëm të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen në librin amë të lindjeve sipas procedurës administrative, dhe të cilët këtë nuk e kanë bërë as duke e parashtruar kërkesën për përcaktimin e amësisë dhe atësisë me procedurë jashtëkontestimore, kanë bërë përpjekje që të drejtën për identitet juridik ta realizojnë me procedurë jashtëkontestimore, duke paraqitur propozimin për konstatimin e fakteve të lindjes. Nga ana tjetër, në rregullat e procedurës jashtëkontestimore nuk ka dispozita të veçanta ligjore mbi të cilët do të zgjidhej statusi ligjor. Edhe në shpjegimet e vendimeve të gjykimeve jashtëkontestimore, qëndrimi më i shpeshtë është se regjistrimi i mëvonshëm mund të bëhet vetëm në bazë të vendimit të organit administrativ të autorizuar për mbajtjen e librave në të cilat bëhet regjistrimi. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se procedura jashtëkontestimore nga natyra është e përshtatshme për t'u marrë me rastet e personave të cilëve nuk është iu pranuar statusi ligjor, duke pasur parasysh lëndën që e rregullon si dhe rregullat dhe natyrën e procedurës.

Për këto arsye, një numër i madh i njerëzve jetojnë me vite në pamundësi për t'u regjistruar në librin amë të lindjeve, dhe me këtë edhe në mundësi për realizimin e të drejtave qytetare dhe njerëzore. Shteti ka për detyrë që, për personat të cilët nuk mund të dëshmojnë identitetin, me krijimin e një procedure të thjeshtë dhe më efikase për zgjidhjen e problemeve të regjistrimit të mëvonshëm në librin amë të lindjeve, t'u ofrojë siguri të plotë ligjore, mbrojtjen efektive gjyqësore dhe trajtim të barabartë në praktikë.

Organizata dhe ekspertë me përvojë në këtë fushë, sidomos Praxis dhe Qendra për Avancimin e Studimeve Ligjore, në bashkëpunim me shërbimet profesionale të këtij organi, kanë përgatitur projekt-tekstin e amendamenteve të Ligjit, i cili për qëllime të efikasitetit i është bashkëngjitur kësaj iniciative. Mendoj se me pranimin e këtij teksti, së bashku me zyrën përkatëse ligjore në Qeveri, apo ministrinë kompetente, do të realizohej synimi i iniciativës:

Ndryshohet Ligji për procedurën jashtëkontestimore ('Gazeta zyrtare e SRS-së', nr 25/82 i 48/88 dhe „Gazeta zyrtare e RS-së“, nr. 46/95 – ligji i dytë dhe 18/2005 – ligji i dytë) ashtu që shtohet:

2A PËRGATITJA E DOKUMENTIT PER FAKTIN E LINDJES

Neni 174a

Personi i cili nuk është i regjistruar në librin amë të lindjeve brenda 3 muajve nga data e parashtrimit të kërkesës për regjistrim të mëvonshëm tek autoriteti përgjegjës për mbajtjen e librit amë, ka të drejtë të regjistrohet në librin amë të lindjeve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 174b

(1) Procedura inicohet sipas detyrës zyrtare, me propozim të personit nga neni 174a, personit tjetër që ka interes të drejtpërdrejtë juridik, organit kujdestar ose organit gjegjësisht organizatës që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

(2) Iniciativën për iniciimin e procesit, pavarësisht propozimit nga paragrafi 1 të këtij neni, e parashtron organi nga neni 174a.

(3) Sipas propozimit, gjegjësisht iniciativës nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, gjykata është e detyruar të veprojë edhe kur nuk mund të dëshmohet emri dhe mbiemri i personit i cili nuk është i regjistruar në librin amë të lindjeve.

Neni 174v

(1) Propozimi nga neni 174B përmban fakte mbi kohën dhe vendin e lindjes, gjinisë, emrit me të cilin personi është i njohur, si dhe faktet tjera relevante që janë të njohura për propozuesin.

(2) Propozimi i cekur në paragrafin 1 përmban informacion edhe për dëshmitarët që do të dëgjohen, dhe mund të përmbajë edhe dëshmi të tjera të cilat janë të njohura për propozuesin.

(3) Bashkë me propozimin, dorëzohet edhe dëshmia e datës së skadimit nga neni 174a.

Neni 174g

(1) Dokumenti me të cilin vërtetohet fakti i lindjes përpilohet në bazë të deklaratave të personave të përmendur në nenin 174a dhe deklaratave të dy dëshmitarëve të rritur, identiteti i të cilëve është i përcaktuar me dokumente publike.

(2) Gjukata në procedurë nga paragrafi 1 i këtij neni mund të parashtrojë edhe prova të tjera në dispozicion.

(3) Dokumenti mund të hartohet edhe jashtë gjykatës sipas kushteve të nenit 166 të këtij ligji.

Neni 174d

(1) Nëse nuk mund të përcaktohet data dhe ora e lindjes së personave që nuk janë të regjistruar në librin amë të lindjeve, konsiderohet se ata janë lindur në 1 janar në ora 00:00 të vitit i cili besohet se është viti i tij i lindjes.

(2) Nëse nuk mund të përcaktohet vendi i lindjes së personit nga paragrafi 1 i këtij neni, konsiderohet se personi ka lindur në komunën apo qytetin në territorin e të cilit është e mundur që lindja të ketë ndodhur, ose është gjetur në atë zonë.

Neni 174gj

(1) Vendimi për hartimin e dokumentit me të cilin konfirmohet fakti i lindjes do të jetë në formë të një vendimi, brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së propozimit.

(2) Dokumenti i faktit të lindjes duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e personit nga neni 174a i këtij ligji, vendin, datën dhe orën e lindjes, dhe nëse kjo është e njohur dhe në këtë rast e përcaktuar në mënyrën e paraparë në nenin 174g të këtij ligji, ose nëse është e përcaktuar në ndonjë mënyrë tjetër në përputhje me ligjin, atëherë edhe emri i plotë i prindërore, data dhe vendi i tyre i lindjes.

(3) Fakti i regjistrimit të të dhënave për prindërit e personave nga neni 174a të këtij ligji nuk e ndalon kontestimin e statusit të tyre prindëror.

(4) Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit 8 ditor nga data e dorëzimit të vendimit, ndërsa gjykata vendosë për ankesën brenda 90 ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

Neni 174e

(1) Vendimi i plotfuqishëm nga neni 174gj dorëzohet brenda afatit 8 ditësh organit administrativ të autorizuar për mbajtjen e librit amë.

(2) Organi kompetent i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, është i detyruar që brenda 3 ditëve nga pranimi i vendimit, të kryejë regjistrimin e mëvonshëm të lindjes në librin amë të lindjeve.

Neni 174zh

Procedura për përgatitjen e dokumenteve me të cilët përcaktohet fakti i lindjes lirohet nga të gjitha tarifatat dhe shpenzimet.

Neni 174z

Në procesin e përgatitjes së dokumenteve për faktin e lindjes, përputhshmërisht aplikohen dispozitat e nenit 71, 167-169,174 të këtij ligji.

Neni 174i

Për procedurën e përgatitjes së dokumenteve lidhur me përcaktimin e faktit të lindjes, ekskluzivisht është e autorizuar gjykata dhe nuk mund të delegohet në juridiksionin e noterit.

MBROJTËSI I QYTETARËVE

Saša Janković

Dorëzuar edhe:

- Ministrisë së Drejtësisë, ministres Snežana Malović
- Praxis-it
- Qendrës për Avancimin e Studimeve Ligjore